

Filloi punimet Konferenca "Menaxhimi financiar i institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë"

Nov 9, 2016



Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami mori pjesë në hapjen e Konferencës dyditore "Menaxhimi financiar i institucioneve publike të arsimit të lartë" e cila organizohet nga MASHT, në bashkëpunim me disa institucione vendore dhe ndër

Qëllimet kryesore të kësaj Konference janë: Prezantimi i rezultateve të projektit "Ngritja e autor

Ilogaridhënies financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", i financuar nga E European, përmes programit Tempus, dorëzimi zyrtar i Dokumentit të Bardhë, që përmbanë propozime lidhje me "Modelin financiar për Sistemin e Arsimit të Lartë Publik në Kosovë" dhe diskutimi për ardhshme të menaxhimit financiar të universiteteve publike.

Ministri Bajrami, e vlerësoi rëndësinë e kësaj Konference, sa i përket gjetjes së mënyrave më të financimit dhe realizimit të plotë të autonomisë financiare të Institucioneve të Arsimit të Lartë, rritjes së cilës do të përkrahë nevojat e tregut të punës dhe profilizimin e fakulteteve, drejt fushave për të cilat ka nevojë.

"Secili universitet duhet të ngritë kapacitetet e brendshme për të dizajnuar planin e zhvillimit strategjik dhe gjenerimin e të hyrave, si një mundësi e zhvillimit të një sistemi konkurent të financimit. Jemi të sigurt që do të zhvillojmë procesin e profilizimit dhe krijimin e identitetit të çdo Institucioni të Arsimit të Lartë", deklaroi Bajrami.

Ministri Bajrami foli edhe për aplikimin e praktikave më të mira të universiteteve ndërkombëtare në formulën e financimit, ndërlidhjen e formulës së financimit me performancën e IAL-së dhe sigurimin e të hyrave vetanake të financimit, në mënyrë që Arsimit të Lartë të jetë një shtyllë e fuqishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe konkurent në shtetet e BE-së.

Ministri Bajrami, po ashtu, ofroi mbështetjen e plotë për programet e reja, të cilat kërkohen nga studentët dhe mundësojnë ndërtimin e tyre në karrierë. „Secili program duhet të ketë disa klauzola shtesë që aplikuar, klauzolën e nevojës së atij programi, klauzolën e punësueshmërisë së studentëve dhe klauzolën financiare", theksoi ministri.

Për rëndësinë e Konferencës folën edhe rektori i Universitetit „Hasan Prishtina" në Prishtinë, z. N. Prizri dhe përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Luigji Brusa.